



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 26.03.2019, ora 10:30

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Republikës së Malit të Zi dhe Komisionit Europian, për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Mali i Zi – Shqipëri, alokimet e vitit 2017” (*Komision për dhënie mendimi*)

2. Miratimi i projektrezolutës “Për vlerësimin e veprimtarisë vjetore të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2018” (*Komision përgjegjës*)

3. Miratimi i projektrezolutës “Për vlerësimin e veprimtarisë vjetore të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi për vitin 2018” (*Komision përgjegjës*)

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Fatmir Xhafaj, Vasilika Hysi, Alket Hyseni, Bashkim Fino, Adnor Shameti, Elena Xhina, Jyrgis Çyrbja, Spartak Braho dhe Xhemal Qefalia

Mungojnë:

Damian Gjikhuri, Tom Doshi

Të ftuar:

Sokol Dedja – Zëvendësministër për Europën dhe Punët e Jashtme

Daniela Çekani – Drejtoreshë e Fondeve të IPA-s në Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme

Iris Kruja – Përgjegjëse e Sektorit të Politikave Ekonomike në Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme

Albana Gërxi – Përfaqësuese e OSBE-së në Shqipëri

HAPET MBLEDHJA

Ulsi Manja – Ftohen mediet të jenë në sallë.

Përshëndetje të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ligjeve për ditën e sotme, meqenëse kuorumi plotësohet për të vazhduar me tri çështjet që kemi në rendin e ditës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fillojmë me çështjen e parë, shqyrtimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Republikës së Malit të Zi dhe Komisionit Evropian, për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Mali i Zi – Shqipëri, alokimet e vitit 2017”. Komisioni ynë në shqyrtimin e këtij projektligji është komision për dhënie mendimi. Relator i këtij projektligji është kolegu Çyrbja.

Kanë konfirmuar pjesëmarrjen nga Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme: zoti Sokol Dedja, zëvendësministër, por për arsye se ndodhet te Komisioni për Politikën e Jashtme, prezantimin e projekt marrëveshjes do ta bëjë zonja Daniela Çekani, drejtoreshë e fondeve të IPA-s, po ashtu kemi prezente edhe zonjën Iris Kruja, përgjegjëse e Sektorit të Politikave Ekonomike.

Zonja Çekani, ju lutem, na bëni një prezantim shumë të shkurtër të kësaj marrëveshjeje për kolegët e komisionit, për të vijuar pastaj me zotin Çyrbja si relator.

Fjala është për ju.

Daniela Çekani – Faleminderit, zoti kryetar!

Qëllimi i këtij projektligji është ratifikimi i marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Republikës së Malit të Zi dhe Komisionit Evropian, përkatësisht për alokimet financiare të vitit 2017. Kjo marrëveshje është në vazhden e marrëveshjeve të tjera që ne kemi ratifikuar tashmë, por për alokimet e viteve specifike përkatëse.

Ratifikimi i kësaj marrëveshjeje do t’i hapë rrugë zbatimit të përbashkët të projekteve ndërmjet të dyja vendeve, Malit të Zi dhe Shqipërisë, në kuadër të bashkëpunimit ndërkufitar, sipas prioriteteve të përcaktuara në program, duke u mundësuar kështu të gjithë aktorëve rajonalë dhe vendorë shkëmbimin e përvojave të suksesshme, duke sjellë edhe rezultate të dukshme në implementimin e përbashkët të projekteve në zonat e lejueshme të programit.

Për Shqipërinë zonat e lejueshme të programit dhe përfituesit e këtyre projekteve janë të vendosur në rrethet: Shkodër, Lezhë dhe Tropojë. Ky grant i Bashkimit Evropian, përkatësisht alokimet e vitit 2017, të cilat ne synojmë t’i ratifikojmë, kapin vlerën e 1 milion e

190 mijë eurosh, duke përfshirë edhe bashkëfinancimin në vlerën prej 210 mijë eurosh. Në total alokimet e vitit 2017 janë në vlerën 1 milion e 400 mijë euro për të dyja vendet.

Aktualisht, kemi lançuar thirrjen e dytë për projektpropozime, në datën 26 shkurt, e cila do të finalizohet në datën 27 maj. Aktualisht, Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme, në rolin e saj si koordinatorë e fondeve të IPA-s, ka planifikuar të zhvillojë sesione informuese në datat 4-5 prill, përkatësisht në Shkodër dhe në Lezhë, për të lehtësuar vendosjen e partneriteteve, njoftimin për procedurat, teknikitetet e ndryshme në lidhje me thirrjen e shpallur tashmë, pra për të lehtësuar përgatitjen e projektpropozimeve dhe një bashkëpunim e komunikim sa më të mirë ndërmjet partnerëve.

Ky ishte një informacion shterues dhe i përmbledhur për projektligjin në fjalë.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Çekani!

Fjalën e ka relatori, zoti Çyrbja.

Jurgis Çyrbja – Faleminderit, zoti kryetar!

Siç e tha edhe zonja Çekani, qëllimi i këtij projektligji është miratimi i marrëveshjes së financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Republikës së Malit të Zi dhe Komisionit Europian, për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Mali i Zi – Shqipëri, alokimet e vitit 2017.

Ky program ka për qëllim kryesor të kontribuojë në zhvillimin social dhe ekonomik të zonave ndërkufitare dhe të rrisë bashkëpunimin ndërmjet të dyja vendeve nëpërmjet ndërhyrjeve të përbashkëta.

Përfitues të këtij programi do të jenë zonat: Shkodër, Lezhë dhe Tropojë. Programi do të fokusohet te nxitja e turizmit dhe e trashëgimisë kulturore e natyrore, mbrojtja e mjedisit, nxitja e punësimit, si dhe te lëvizja gjeografike e punonjësve dhe përfshirja sociale e kulturore përtej kufijve.

Në përfundim të fjalës sime, për sa i përket aspektit ligjor, projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe në aspektin procedural është në përputhje me Rregulloren e Kuvendit. Në këto kushte, ftoj anëtarët e komisionit ta miratojnë këtë projektligj.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Çyrbja!

Ka pyetje nga kolegët?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, zoti Fino.

Bashkim Fino – Ky është një grant dhe rialokim i vitit 2017, pra nuk ka ndonjë vlerë të madhe, aq më tepër që shuma është simbolike, por drejtoresha e IPA-s, a mund të na japë një informacion më të detajuar në lidhje me këtë projektligj, sidomos për qëllimin për të cilin do të jepen këto fonde, se në relacion thuhet vetëm: “Për nxitjen e turizmit dhe trashëgimisë kulturore”, por si do të bëhet? Gjithashtu, në relacion thuhet: “Mbrojtja e mjedisit dhe nxitja e përshtatjes dhe lehtësimit të ndryshimeve klimaterike, por, mbi të gjitha, nxitja e punësimit dhe lëvizja gjeografike e punonjësve”. Mos ndoshta do të ishte mirë edhe për publikun të kishim një informacion pak më të detajuar, sepse ne thjesht miratojmë kalimin e fondit dhe shkon tutje, por çështja është si realizohen këto, pavarësisht se ne, si Shqipëri, përfitojmë vetëm në tri bashki: Shkodër, Lezhë dhe Tropojë, ndërkohë që Mali i Zi ka mbi 15 njësi vendore përfituese nga ky fond?

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Fino!

Po, zonja Çekani.

Daniela Çekani – Faleminderit për pyetjen!

Për sa i përket numrit të popullsisë, duhet thënë se në këto programe bashkëpunimi ndërkufitar, sidomos në programet që janë edhe bilaterale, qëllimi është që përfituesit në numër popullsie të jenë në nivele të përafërta, pavarësisht numrit të bashkive apo qarqeve. Nga njëra palë, nga ana shqiptare, dhe nga ana malazeze, përgjithësisht synohet të ketë një numër popullsie të përafërt, që përfitojnë në mënyrë të barabartë nga të dyja vendet, pra pavarësisht nga ana numerike e këtyre qarqeve.

Për sa u përket prioriteteve të programit, në program ato janë të artikuluar në mënyrë narrative dhe pak të gjerë. Përfituesit e projekteve (aplikantët e mundshëm) nisen gjithmonë nga fusha e tyre e veprimt dhe e ndërhyrjeve, për të cilat ata janë të specializuar apo kanë një eksperiencë të mirëfilltë.

Partneritetet krijohen bazuar në vullnetin e lirë të aplikantëve. Minimalisht duhet të ketë një aplikant nga pala shqiptare dhe një aplikant tjetër nga pala malazeze, por kjo është vetëm në limite, pra minimalisht një. Kjo do të thotë që si në numër, bazuar edhe në fushën e kompetencës që ato kanë, mund të krijojnë një *partnership*, duke dizenuar ndërhyrje konkrete specifike, që, sigurisht, mbeten në vendimmarrjen dhe në fokusin e vetë aplikuesve. Ndërsa në program këto janë të shpjeguara në mënyrë narrative, pra më gjerë.

Sigurisht, mund të kemi ndërhyrje të karakterit infrastrukturor, por jo ndërhyrje që kërkojnë investime në vlera monetare të konsiderueshme, sepse këto programe kanë ndërhyrje të një niveli më të butë; mund të kemi shkëmbime eksperience në nivel trajnimesh, ndërhyrje

nëpërmjet shkëmbimit të eksperiencave ndërmjet dy vendeve... Pra, janë gjithmonë të karakterit pak më *soft*, nëse mund ta quajmë kështu, dhe jo ndërhyrje infrastrukturore të mirëfillta për vetë alokimet financiare që këto programe ofrojnë.

Për ndërhyrje të një karakteri më të madh, kemi programe të tjera, sigurisht edhe nëpërmjet IPA-s kombëtare, që lejon ndërhyrje të këtij karakteri. Pastaj, natyra specifike e ndërhyrjes varet nga vetë përfituesit dhe nga fusha e tyre e ekspertizës.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Çekani!

Ka pyetje të tjera nga kolegët? Nuk ka.

Ka diskutime? Nuk ka.

Atëherë, kalojmë në votimin në parim të këtij projektligji.

Kush është dakord në parim me projektligjin? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në parim projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Republikës së Malit të Zi dhe Komisionit Europian, për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Mali i Zi – Shqipëri, alokimet e vitit 2017”.

Kalojmë në shqyrtimin dhe votimin nën për nën të këtij projektligji.

Neni 1. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi.

Kush është dakord në tërësi me projektligjin? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në tërësi projektligji.

Relatori dhe këshilltari i komisionit të bëjnë gati raportin dhe t’ia përcjellin komisionit përgjegjës dhe më pas seancës plenare për votim.

Zonja Çekani, shumë faleminderit për prezencën! Ditë të mbarë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 26.03.2019, ora 10:30

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Miratimi i projektrezolutës “Për vlerësimin e veprimtarisë vjetore të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2018” (*Komisioni përgjegjës*)

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Fatmir Xhafaj, Vasilika Hysi, Alket Hyseni, Bashkim Fino, Adnor Shameti, Elena Xhina, Jyrgis Çyrbja, Spartak Braho dhe Xhemal Qefalia

Mungojnë:

Damian Gjikhuri, Tom Doshi

Ulsi Manja – Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës, miratimin e projektrezolutës “Për vlerësimin e veprimtarisë vjetore të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2018”.

Komisioni ynë është komisioni përgjegjës për miratimin e kësaj projektrezolute. Relatore është kolegja Elena Xhina.

Zonja Xhina, tekstin e projektrezolutës kolegët e kanë përpara, ndaj do t’ju lutesha të na thoni shkurtimisht se cilat janë gjetjet që keni evidentuar në lidhje me veprimtarinë e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe cilat janë detyrat që Kuvendi do t’i bëjë pjesë të projektrezolutës për veprimtarinë e Komisionerit për vitin që vjen.

Elena Xhina – Faleminderit, zoti kryetar!

Jemi përpjekur që në tekstin e projektrezolutës të përmbliidhen të gjitha shqetësimet që u ngritën në komision si nga Komisioneri, në prezantimin e punës së tij, ashtu edhe nga anëtarët e komisionit, kryesisht nga zonja Hysi, dhe diskutimi që u mbajt nga ana juaj lidhur me median *online*.

Në tekstin e rezolutës ne kërkojmë që Komisioneri të angazhohet si në vijim të përmbushjes së detyrimeve të tij të përcaktuara me ligjin specifik, po ashtu të angazhohet edhe më tepër në problematikat që ai vetë ka parashtruar nën tekstin e raportit, për të bërë një monitorim të mëtijshëm të organeve vendore dhe të institucioneve, që kanë për detyrë respektimin e të drejtave personale dhe ruajtjen e tyre.

Teksti i projektrezolutës u është shpërndarë deputetëve. Në qoftë se është e nevojshme dhe mund ta lexojmë, dakord, por risitë janë pikërisht vetëm në këto drejtime.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Xhina!

Ka sugjerime nga kolegët në lidhje me tekstin e projektrezolutës?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Lidhur me projektrezolutën, janë pasqyruar, me të drejtë, të gjitha problematikat, por sugjerimi i vetëm që kam është për ta riformatuar në formatin standard, me qëllimin që të shmanget togfjalëshi “Zyra e Komisionerit” kudo. Kam parasysh një vërejtje që, në fakt, e ka bërë vazhdimisht zoti Fino, por edhe vërejtjen që kemi bërë, që të lëmë disa afate konkrete. Pra, në kërkesat që Kuvendi i Shqipërisë ka për Zyrën e Komisionerit për vitin 2019 të jemi pak më konkretë, që të kemi mundësi edhe ta matim përmbushjen e rekomandimit, sepse kur thuhet: “Thellimi i mbikëqyrjes dhe monitorimit të zbatimit të ligjit”, kjo është shumë e gjerë, pasi si do të matet? Do të rrisim numrin e monitorimeve proaktive? Do të rrisim numrin e hetimeve administrative? Pra, të kemi disa tregues, përndryshe do të gjendemi në vështirësi dhe do të themi: “këtë e ka realizuar mirë, se kështu e thotë raporti” ose “këtë rekomandim nuk e ka përmbushur mirë, sepse e tillë është problematika që shqyrtohet”.

Ulsi Manja – Po, zonja Xhina.

Elena Xhina – Faleminderit, zonja Hysi, për sugjerimin!

Realisht është e vërtetë që kemi diskutuar gjithmonë që rezoluta duhet të jetë sa më efektive dhe të prodhojë të vërtetat që ne presim nga organet e pavarura, por që rezoluta ka afatin e saj njëvjeçar kuptohet, sepse ne në fund të një viti bëjmë panoramën se çfarë është realizuar ose jo nga Komisioneri. Unë pikërisht këtë theksova, që në detyrimet që kemi dhënë

është zbatimi i ligjit, nuk kemi kërkuar asgjë përtej detyrimeve që i ka të përcaktuara me ligj. Megjithatë, unë jam e hapur ndaj çdo propozimi që bëhet, pra mund ta vendosim pa asnjë problem.

Faleminderit!

(Deputeti Fino ndërhyr pa mikrofon.)

Po.

(Deputeti Fino ndërhyr pa mikrofon.)

Vasilika Hysi – Kështu është e saktë.

Elena Xhina – Është rakorduar...

Ulsi Manja – Duke u bashkuar me kolegen Hysi për aspektet e formulimit sipas teknikës legjislativë në lidhje me tekstin e projektrezolutës, unë gjykoj se rezoluta është e rakorduar edhe me Komisionerin, por janë mbajtur parasysh edhe sugjerimet e bëra gjatë diskutimit në parim ditën që ai raportoi. Ndaj mendoj ta votojmë tekstin e kësaj projektrezolute.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kush është dakord me projektrezolutën “Për vlerësimin e veprimtarisë vjetore të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2018”? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Atëherë, teksti i kësaj projektrezolute t’i kalojë seancës plenare për votim.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 26.03.2019, ora 10:30

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Miratimi i projektrezolutës “Për vlerësimin e veprimtarisë vjetore të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi për vitin 2018” (*Komision përgjegjës*)

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Fatmir Xhafaj, Vasilika Hysi, Alket Hyseni, Bashkim Fino, Adnor Shameti, Elena Xhina, Jyrgis Çyrbja, Spartak Braho dhe Xhemal Qefalia

Mungojnë:

Damian Gjikhuri, Tom Doshi

Ulsi Manja – Kalojmë në pikën e tretë dhe të fundit të rendit të ditës, që është miratimi i projektrezolutës “Për vlerësimin e veprimtarisë vjetore të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi për vitin 2018”.

Jemi komision përgjegjës, relator është kolegu Alket Hyseni.

Tekstin e projektrezolutës e keni përpara.

Zoti Hyseni, ju lutem, na bëni një prezantim shumë të shkurtër të tekstit të projektrezolutës, për të vijuar më pas me sugjerimet nga kolegët nëse do të ketë.

Fjala është për ju.

Alket Hyseni – Faleminderit, zoti kryetar!

Rezoluta për veprimtarinë e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi për vitin 2018 kryesisht ka një vijimësi nga rezoluta e vitit të kaluar, nga ato detyra bazë dhe kushtëzime që ligji i ka përcaktuar Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, duke pasur parasysh arritjet që ai ka pasur, pasi i vlerëson ato arritje, por në mënyrë të veçantë fokusin e ka te sfidat e reja që dalin para Komisionerit për vitin 2018.

Edhe nga raportimi që Komisioneri pati është vërejtur se puna e komisionerit gjatë vitit 2018 ka pasur përmirësime të dukshme, por pavarësisht përmirësimit, sikurse e thamë edhe në diskutim, asgjë nuk është perfekte, pra ka pasur nevojë për rritjen e prezantimit të Komisionerit në publik. Një nga këto kërkesa që rezoluta e re i cakton, është angazhimi më i madh i komisionerit në publik në media, shoqëri civile, për të bërë të mundur që çdo qytetar i Republikës së Shqipërisë dhe çdo subjekt të jetë në dijeni që ekziston Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimin.

Puna e bërë nga komisioneri është risi e madhe. Para 2-3 vjetëve nuk njihej absolutisht, por puna e bërë vitin e kaluar ka bërë që komisioneri të jetë jo thjesht një strukturë e përcaktuar nga ligji, jo thjesht një institucion formal që ekziston në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, por të jetë një mekanizëm eficient. Këtë ka synuar kjo rezolutë.

Strukturës së komisionerit, i cili vjen me mbështetje të plotë nga parlamenti, si me mjete logjistike, ashtu dhe personel, i kërkojmë rritjen e rolit monitorues në drejtim të zbatimit dhe respektimit të barazisë dhe mbrojtjes nga diskriminimi, ku jemi koshientë që akoma ka forma të diskriminimit, të realizojë monitorimin e aksesueshëmërisë së personave me aftësi të kufizuara në tre fusha bazë: punësimit, arsimit dhe të mirave dhe shërbimeve, të fuqizojë bashkëpunimin me aktorët e shoqërisë civile që kontribuojnë në këtë fushë, duke menduar që janë aktorë shumë të rëndësishëm dhe shpeshherë janë ata identifikuesit e parë të problematikave që ndodhin, të shfrytëzojë bashkëpunimin me median si një burim tjetër

alternativ edhe për evidentimin e problematikave, por edhe për sensibilizimin e shoqërisë, të shtojë shtrirjen në territor për shkak të hapjes së zyrave vitin e kaluar, të realizojë mbulimin me buxhet të zyrave rajonale të komisionerit, si dhe të rrisë mundësinë e shtrirjes në territor në mënyrë që personat që mund të kenë nevojë t'i adresohen komisionerit, ta bëjnë atë në një kohë të shpejtë dhe sa më afër.

Pra, komisioneri si institucion të jetë më i prekshëm, pasi jemi koshientë që janë shtresat më vulnerabël, të cilat shpesh e kanë të pamundur të ushtrojnë të drejtën e tyre të ankimit të prezantimit të situatës për shkak të largësisë, të mosnjohjes së ligjit, të mungesës së teknologjisë që zotërojnë ata e të tjera. Këto janë pak a shumë ato që rezoluta e re paraqet. Është një rezolutë e dakordësuar me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ndaj unë e ftoj e komisionin ta miratojë atë, edhe pse me ndonjë rezervë të teknikës legislative dhe të termave të përdorur. Për shembull, në paragrafin e fundit, nuk mund të përdoret termi “të përdorë median”, sepse është i papërshtatshëm, por duhet të zëvendësohet me një term të sensit “të bashkëpunojë me median”. Kjo për ta bërë më të pranueshme nga pikëpamja e teknikës, por edhe nga pikëpamja e leksikut.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Hyseni!

Ka sugjerime nga kolegët për rezolutën?

Po, zoti Fino.

Bashkim Fino – Nuk fola për rezolutën e parë, por do të flas për këtë. Nuk dua të më keqkuptojë relatori, sepse e kam parimore.

Në përgjithësi unë jam kundër rezolutave që bëjmë, sepse ato janë thjesht orientuese, deklarative dhe, në fund të fundit, nuk i shërbejnë asgjëje për të cilën këto institucione janë krijuar. Më i rëndësishëm për ne duhet të jetë kontrolli që duhet të bëjmë në këto institucione gjatë vitit kalendarik, fuqizimi me informacione që do të na japin komisionerët e veçantë dhe, mbi të gjitha, raportimi i tyre këtu për punën e tyre. Të thuash në rezolutë që Kuvendi i Shqipërisë kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi që gjatë vitin 2019 të angazhohet në këto drejtime dhe të rendisë 14 paragrafë, do të thotë t'i thuash komisionerit koleg. Pra, t'i thuash shiko 14 pikat që të ka dhënë parlamenti dhe mos e çaj kokën për ligjin që ke apo për të gjithë veprimtarinë që ke gjatë vitit.

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

I tërheq vëmendjen dhe e kam për ta rregulluar. Ti nuk je relator dhe mbase s'je shumë i interesuar. Do të thotë se kur është deklarative dhe orientuese, i thuhet komisionerit

se duhet të kesh në vëmendjen tënde, sidomos gjatë vitit 2019, përveç punës së përditshme, edhe këto çështje, të cilat ne dhe nënkomisionet tona përkatëse duhet t'i monitorojnë gjatë vitit me idenë që kur të vijë në fund ose në fillim të vitit tjetër për raportin përkatës të shikohet sa janë realizuar ato gjëra që kemi shënuar, siç bëra unë dje me KQZ-në për të treguar se sa ata kanë punuar, kur thashë se sipas orientimeve që kemi dhënë në vitin 2017, kjo është bërë, kjo nuk është bërë dhe kjo është bërë pjesërisht.

Në fund të ditës ky komision nuk është thjesht kalim verbal i veprimtarisë së këtyre komisionerëve me idenë që erdhën, raportuan, ikën, thanë diçka dhe nuk u bë asgjë. Këta duhet të kuptojnë që, kur raportohet, do të thotë se t'i raporton për punën tënde profesionale, e ke realizuar apo jo dhe në fund të ditës duhet të vendosësh nëse je i aftë për të qenë në krye të këtij institucioni (nuk e kam për rastin konkret, por parimore) apo nuk je, në mënyrë që Kuvendi të marrë vendimin e nevojshëm nëse nuk realizohet ndonjë gjë.

Prandaj, mbase do të ishte mirë që këto detyra konkrete të vihen nga komisionet përkatëse, që janë të specializuara dhe që janë këtu prezente, sepse ne angazhojmë të gjithë deputetët e Kuvendit të Shqipërisë për të miratuar një rezolutë. Në fund të fundit, e kanë mbi tryezë në seancë plenare, por nuk janë të angazhuar sa dhe siç duhet si komisioni ynë që merret gjithë vitin me këta komisionerë apo veprimtarinë e tyre. Mendoj që edhe ju duhet ta shikoni pak më hapur, në sensin që duhet bërë një ndryshim thelbin e këtyre rezolutave që janë deklarative dhe orientuese, por aspak imponuese. Kur them imponuese, ata duhet ta zbatojnë, të jenë korrektë, të raportojnë, të sjellin informacion, të shkojmë ne të kontrollojmë të tjera me radhë, sepse vetëm kështu mund të bëhen më efektive këta komisionerë që ne kemin krijuar me ligj të posaçëm. Në të kundërt, këto janë gjëra që vazhdojnë kështu çdo vit, flasin, na sjellin ndonjë material të bukur, diskutohet, bëhen pyetje dhe më tutje nuk zgjidhet asgjë. Mua më duket jo korrekte në sensin se si ne harxhojmë kohën duke shkruar të gjithë këto gjëra dhe i themi atij që t'i do të kesh këto drejtime. Jo, drejtimet ai i ka, sepse është krijuar me ligj, por përveç këtyre ne duhet të themi të metat dhe dobësitë e vitit 2018. Ne sugjerojmë që gjatë vitit 2019, përveç të gjithë veprimtarisë që ke me ligj, ke edhe këto pesë çështje që ne do t'i kontrollojmë në 4-mujorin e parë, e kështu me radhë. Më pas të vijmë në konkluzionin që me të vërtetë disa gjëra bëhen, por kanë një vlerë. Të mos jetë thjesht një vlerë orientuese dhe deklarative, por të ketë një vlerë të kontrollit parlamentar nga ky komision i rëndësishëm.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Fjalën e ka zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Faleminderit!

Zoti kryetar, jam absolutisht në një linjë me atë çfarë tha kolegu Fino. E lexova me vëmendje pjesën e kërkesave që Kuvendi i Shqipërisë ka ndaj Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi për vitin 2019, por do të sugjeroja të ishim më konkretë. Konkretisht, në paragrafin e parë, kur thuhet të rrisë rolin monitorues të institucionit në drejtim të zbatimit, respektimit të barazisë dhe mbrojtjes nga diskriminimi duke pasqyruar gjetjen e monitorimit, me raporte të veçanta, t'i kërkojmë komisionerit paraqitjen në komision të një raporti të veçantë për dy çështje:

E para, viti 2019 është viti i aksesueshëmërisë. Përderisa është deklaruar nga qeveria si viti i aksesueshëmërisë, angazhohet qeveria për të monitoruar zbatimin e konventës për personat me aftësi të kufizuara, ne duhet t'i kërkojmë një raport të veçantë. Në këtë kuadër, ka një pikë ku thuhet që të realizojë monitorimin e aksesueshëmërisë. Këto mund të bashkohen bashkë dhe të themi: të paraqesë një raport të veçantë brenda muajit shtator, tetor apo nëntor, por të ketë një raport dhe një afat deri kur do të sjellë një raport të veçantë për aksesueshmërinë.

E dyta, ne kemi marrë një angazhim për fëmijët dhe vetë komisioneri ka adresuar në parlament një kërkesë ku kërkon të jetë pranishëm për të gjithë projektligjet dhe diskutimet që bëhen për çështjet e të drejtave të fëmijëve. Kjo kërkesë e drejtë e tij për të parandaluar diskriminimin e fëmijëve, sugjeroj të shtohet këtu, apo jo zoti Hyseni? Është kërkuar, meqenëse Shqipëria këtë vit raporton në Gjenevë për konventën dhe besoj se menjëherë do të vijjnë rekomandimet nga Gjeneva. Pse të mos jetë Komisioneri për të monitoruar zbatimin e këtyre rekomandimeve, duke bërë ne një rekomandim konkret?

Lidhur me rekomandimin për të forcuar rolin e institucionit të bashkive, ku Komisioneri ka zyra rajonale, unë mendoj se roli i institucionit duhet të forcohet kudo, por në mënyrë të veçantë të na paraqesë një raport sa efektive janë komisionerët dhe zyrat rajonale. I kemi miratuar këtu, duke i mbështetur, u kemi parashikuar buxhet dhe zoti Fino e ka rritur numrin e tyre. Tani duam të dimë nëse janë efektive këto zyra. Pra, unë sugjeroj që brenda këtij viti të kemi një raport të Komisionerit të paraqitur pranë Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut për aktivitetin e zyrave rajonale dhe për efektivitetin e punës së tyre. Nëse aty nuk ka kërkesa, nuk ka ankesa, nuk ka veprimtari dhe ne mbajmë zyrat rajonale, ka diçka që duhet përmirësuar. Do të sugjeroja që të shtohet që brenda muajit shtator të paraqesë pranë Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut një raport të posaçëm për veprimtarinë e zyrave rajonale të tij.

E fundit, lidhur me çështjen që lidhet me medien. Jam dakord me shqetësimin e zotit Hyseni për gjuhën që është përdorur, por nga ana tjetër, do të sugjeroja se ne kemi një problem shumë të madh me lajmet e rreme, me dezinformimet, me gjuhën e urrejtjes, me diskriminimin në medie.

Do të doja një rekomandim konkret, një nismë konkrete të Komisionerit me medien, sepse media do të vetërregullohet jo thjesht për ta përdorur medien (kërkoj ndjesë që po e përdor edhe unë fjalën “përdorje”), për të qenë i pranishëm në medie për promovimin e luftës kundër diskriminimit, por në radhë të parë, për të luftuar dhe për të parandaluar gjuhën e urrejtjes, gjuhën diskriminuese, homofobinë, ksenofobinë, racizmin dhe gjithçka tjetër që ka në blogje etj. Ndoshta, këtu do të doja edhe një sugjerim nga kolegu Hyseni. Ne mund të kërkonim që të organizohet një veprimtari, ku të ishin edhe Komisioni i Medies, edhe Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut për ta inkurajuar medien për të bërë një vetërregullim të parandalimit të gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimit në mediet *online*. Do të ishte mirë që brenda muajit tetor, të organizohej një debat me përfaqësuesit e medies, të shoqërisë civile, ekspertët e pavarur dhe deputetët e Kuvendit të Shqipërisë.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Hysi!

Ka sugjerime të tjera nga kolegët?

Urdhëroni zoti Hyseni, si relator për të bërë një përmbledhje!

Alket Hyseni – I falënderoj kolegët për sugjerimet e vlefshme!

Për mendimin tim, një pjesë e madhe e tyre duhen patjetër. Ashtu siç e theksova, së pari ka nevojë për rregullimin e termave dhe që nga sugjerimi i kolegut Fino që patjetër, nuk mundt të thuhet se angazhohet vetëm në këto drejtime. Unë e pata lënë edhe porosi këtu të thuhej: veçanërisht në këto drejtime, sepse detyrimet bazë ai i merr nga ligji, nuk i merr nga rezoluta.

Nga ana tjetër, unë nuk mund të bie 100% dakord me faktin që ne nuk mund të shkojmë përtej një rezolute. Ne vërtet jemi organi ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jam absolutisht dakord, që ne duhet të jemi më të angazhuar jo vetëm në këtë rast, por me të gjitha institucionet nën varësinë e parlamentit. Duhet të jemi më të kujdesshëm, sepse një pjesë e legjislacionit e përcakton qartë se kur raportojnë. Ne nuk mund të dalim mbi

atë që jep ligji. Ka raste kur ligji është taksativ dhe thotë se raportohet një herë në vit, ose thotë: jo më pak se një herë në vit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ne kemi mekanizma, të cilat nuk i shfrytëzojmë. Të mos harrojmë mekanizmat e fuqishme parlamentare që ne kemi, të cilat ne nuk i shfrytëzojmë (as mekanizmat individuale në masën e duhur, as ato kolektive) në kuadër të komisioneve.

Rezoluta është rezolutë. Ajo mbetet deklarative, por kur vjen puna te raporti ne kemi të gjithë të drejtën t'i themi kujtdo institucioni që nuk ka përmbushur 1-2-3-4 rekomandime dhe kështu, ai mund të mos e kalojë klasën. Nëse ka mekanizma, t'i shohim një herë, dy herë dhe të vendosim që është i papërshtatshëm për ta kryer atë detyrë. Ne nuk mund të shkojmë përtej një rezolute në këto raste. Prandaj i ftoj kolegët të jenë të kujdesshëm dhe që çdo gjë të mbetet në kuadrin e një rezolute kërkuese, patjetër.

Nga ana tjetër, nëse ka vërejtje të qenësishme që mund të pranohen dhe unë i mbajta shënim, por unë nuk bie dakord për çështjen e zyrave. Zyrat janë bërë për herë të parë buxhetore këtë vit. Ato kanë qenë me projekte. Zyrat janë bërë për herë të parë buxhetore dhe shqyr që janë bërë. Ato nuk janë për bashkitë. Unë e kisha shënuar termin të hiqej, sepse ato vërtet janë vendosur pranë bashkive, por janë rajonale, pikërisht për të qenë sa më afër territorit, që të mos jetë vetëm zyra qendrore e Tiranës. Ato zyra janë të domosdoshme. Ne kemi diskutuar bashkë jo vetëm këtë çështje, por në shumë aspekte që një personi, që i preken të drejtat sa të marrë rrugën e të vijë në Tiranë, e lë fare, se ai nuk ka as mundësitë financiare, as njohuritë se ku janë institucionet.

Duke qenë më afër në territor, mund ta ketë në qytet, apo në qytetin apo në bashkinë pranë dhe e ka më të lehtë për t'u aksesuar. Kështu, unë mendoj se duhet t'i inkurajojmë ato zyra dhe jo t'i mbajmë në provë dhe të themi se po nuk dhanë efekt. Ato patjetër duhet të japin efekt. Është shumë e rëndësishme, që ato ta japin efektin dhe ne duhet t'i inkurajojmë edhe në këtë rezolutë.

Ka edhe momente, ku duhet ndërhyrë. Janë paragrafë, që janë shkëputur gabimisht, se duhet të ishin pranë njëri-tjetrit, siç është paragrafi: “Të forcohet roli i institucioneve, ku KMD ka zyrat rajonale”, me paragrafin: “Për të zgjeruar aktivitetet gjithëpërfshirëse, ndërgjegjësuese...”

Unë u kërkoj kohë kolegëve që ta miratojmë në parim rezolutën dhe ndoshta ta riformatojmë për leksikun dhe për teknikën legjislative, ta kompletojmë dhe t'ia paraqesim të kompletuar Kuvendit, duke marrë parasysh edhe sugjerimet e kolegëve.

Faleminderit, kryetar!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Hyseni!

Urdhëroni, zoti Fino!

Bashkim Fino – Faleminderit, kryetar!

Unë pa dashur të debatoj me zotin Hyseni, sepse unë u tregova shumë i kujdesshëm në ato që thashë, nuk ka nevojë të etiketohemi që të jemi të kujdesshëm. Unë diskutova në parim për projektrezolutat në tërësi.

Javën që vjen do të vijë projektrezoluta për KQZ-në, për të cilën unë jam relator. Të njëjtin mendim ndaj edhe për deklaratën që do të bëjmë për KQZ-në, se nesër mund të ngrihen kolegët e mi e të thonë se ti sot je relator dhe ne do të bëjmë këto propozime që ti i bërë para një jave. Pra, diskutimi im është në parim. Mund t'ia lëmë kohës dhe në një kohë më të përshtatshme ne si komision mund të bëjmë një diskutim më të gjerë për këtë punë. Mund ta diskutojmë në Byronë e Kuvendit për të pasur një vendimmarrje, sepse unë bëra edhe një propozim konkret, të cilin nuk mund ta vendosim ne këtu. Ishte një diskutim në parim: pse jo këto projektrezoluta mund të kalojnë thjesht vetëm në komisione? Të mos shpiem në parlament dhe t'i detyrojmë deputetët të votojnë për një rezolutë, të cilën nuk e njohin, nuk kanë informacion për të dhe duhet ta votojnë, se e kanë mbi tryezë.

Pra, ky është një diskutim jashtë këtyre dy projektrezolutave, që po votojmë.

2 sugjerimet që unë bëra, zoti Hyseni i pranoi me kënaqësi të madhe dhe ato ndryshime që edhe ai i pranon, edhe ne jemi dakord, nuk ka asnjë problem që të quhet rezolutë, por diskutimi im ka të bëjë me thelbin se si duhet të veprojmë që të mos mbetet thjesht në kuadër të një copë letre që kalon në fillim të vitit, vjen edhe vitin tjetër dhe bëjmë përsëri po të njëjtën gjë dhe nuk nxjerrim asgjë. Të paktën kështu mendoj unë. Ndoshta e kam gabim, por kjo është e drejta ime dhe unë besoj se jam shumë i kujdesshëm në këtë pikë, apo jo?

Faleminderit, kryetar!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Fino!

Fjalën e ka kërkuar zonja Mara.

Aurora Mara – Përshëndetje të gjithëve!

Unë kisha një sugjerim. Për të shtuar eficiencën e të gjitha rekomandimeve që janë lënë më sipër, mendoj që në fund të pikave të shtojmë një pikë, ku mund të thuhet se Komisioneri të raportojë në mënyrë periodike për të gjitha angazhimet e mësipërme. Me këtë ne e përmbledhim komplet angazhimin e Komisionerit, duke mos dalë nga korniza ligjore, sepse mendoj se raportimi është diçka shumë normale nga momenti që merren angazhimet.

Në këtë mënyrë duket para Kuvendit edhe efienca e të gjithë punës së Komisionerit edhe para angazhimeve që i janë dhënë.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit!

Besoj se nuk ka sugjerime të tjera nga kolegët. Do të doja të kishte një sugjerim kolegu Shameti, edhe si profesor i së drejtës në universitet, por gjithsesi duket se është shumë i qartë me tekstin e rezolutës.

Para se ta hedhim në votim tekstin e projektrezolutës, unë bashkohem me të gjitha shqetësimet e ngritura nga kolegët. Vazhdimisht në këtë komision është evidentuar fakti që rezolutat nuk duhet të jenë klishe standarde.

E dyta, për sa i përket teknikës legjislative, relatorët dhe këshilltarët duhet të heqin dorë nga shkurtimi i fjalëve. Mund të ketë në tekstin e një projektrezolute KMD, KMSHC-ja e kështu me radhë. Kjo është një çështje themelore e teknikës legjislative. Jo të gjithë qytetarët që marrin në dorë një rezolutë të votuar në Kuvend, janë të familjarizuar me shkurtime të termave ligjore. Ne nuk i miratojmë këto rezoluta për vete, nuk i miratojmë thjesht dhe vetëm për një kategori të caktuar qytetarësh që kanë një formim juridik, por jo vetëm. Tekstet e këtyre rezolutave bëhen publike dhe janë të aksesueshme nga publiku i gjerë.

E treta, rezoluta përfshin aktivitetin 1-vjeçar të punës së Komisionerit dhe këtu jam dakord me kolegen Xhina lidhur me diskutimin, nëse do të duhet të ketë afate të përcaktuara për detyrat që lë Kuvendi në një rezolutë, apo jo.

Të mos harroni të nderuar kolegë, që ne kemi në dorë të gjitha instrumentet e duhura për ta ushtruar siç duhet kontrollin parlamentar mbi këto institucione, që janë në fushën e përgjegjësisë së Komisionit të Ligjeve, dhe të Kuvendit të Shqipërisë. Ne kemi 3 nënkomisione dhe unë jam shumë dakord që ta shkruajmë në tekstin e projektrezolutës që këto institucione raportojnë te ne në mënyrë periodike, por bëjnë një raportim periodik nga të gjitha institucionet e pavarura që janë në sferën e përgjegjësisë të komisionit tonë, sjellin raporte periodike 3-mujore, në lidhje me aktivitetin e tyre. Vitin që shkoj unë ua kam vënë në dispozicion këto raporte periodike 3-mujore nënkomisioneve përkatëse. Nëse nënkomisionit përkatës të këtij komisioni çmojnë se komisionerët apo drejtuesit e këtyre institucioneve të pavarura duhet të thirren në një seancë dëgjimore në Komisionin e Ligjeve për problematika të caktuara, pse jo, por kjo është detyra jonë.

Jam plotësisht dakord (po i kthehem gjuhës së përdorur në tekstin e projektrezolutës) që në paragrafin, ku thuhet se Kuvendi i Shqipërisë i kërkon Komisionerit për Mbrojtjen nga

Diskriminimi për vitin 2019 të angazhohet në këto drejtime, të riformulohet, të hiqet ky tekst. T'i referohemi faktit që detyrimet burojnë nga ligji, siç e tha zoti Hyseni, por Kuvendi përpos detyrave që i ngarkon ligji, kërkon nga Komisioneri edhe angazhimin në këto drejtime.

Me këto sugjerime që janë tërësisht racionale, se ne do të kemi në ditët në vazhdim edhe rezoluta të tjera për të miratuar në këtë komision, unë them ta hedhim në votim dhe të reflektohen të gjitha sugjerimet e bëra nga kolegët.

Kush është dakord me projektrezolutën “Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionit për Mbrojtjen nga Diskriminimi për vitin 2018”, duke reflektuar sugjerimet e kolegëve?

Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Teksti i kësaj projektrezolute të bëhet gati dhe t'i kalojë seancës plenare për votim!

Me votimin e kësaj projektrezolute e mbyllim mbledhjen e komisionit për ditën e sotme.

Shumë faleminderit!

Ditë të mbarë!

Për kujtesë për kolegët e Komisionit të Ligjeve, nesër në orën 12:00 kemi një tryezë konsultimi publik për projektligjin për shërbimin përmbartimor privat në sallën e katit të katërt, të godinës së Kuvendit.

Shumë faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA